

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ilmije Zeka, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.Sh., nga Prizreni, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 dhe nën par. 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së të dëmtuarit Naser Pajaziti, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1000/2016, datë 22.08.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur, më 17.01.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e të dëmtuarit Naser Pajaziti, kurse aktgjykimi i Prizren, P.nr.1000/2016, datë 22.08.2017, **vërtetohet**.

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin P.nr.1000/2016, datë 22.08.2017, të akuzuarin A.Sh., e ka shpall fajtor për veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 dhe nën par. 1.4 të KPRK-së, për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale. I dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil. Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës dhe atë në emër të ekspertizës për ekspertin mjeko ligjor të paguaj shumën prej 20 €, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm. Mbikëqyrjen e dënimit me kusht do ta bëjë Shërbimi sprovues në Prizren, në pajtim me nenin 159 par. 1 të LESP-së.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i dëmtuari Naser Pajaziti, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kurse nga përmbajtja del se po ashtu aktgjykimin e ka ankimuar edhe sa i përket vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim më të rëndë.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1303/2017, datë 13.12.2017, ka propozuar që ankesa e të dëmtuarit sa i përket vendimit mbi dënim të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ashpër, ndërsa sa i përket vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal të hidhet si e palejuar.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

### **Ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse i dëmtuari nuk ka të drejtë që të ankimohet, aktgjykimin e shkallës së parë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

I dëmtuari me ankesë e ankimon aktgjykimin e ankimuar sa i përket shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo, kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se ankesa në këtë drejtim nuk është e lejuar, për faktin se në dispozitën e nenit 381 par. 1 të KPPK-së përcaktohet se cilët janë personat e autorizuar për paraqitjen e ankesës, ndërsa në paragrafin 3 të të njëjtit nen, shprehimisht është përcaktuar se “i dëmtuari mund të ushtroj ankesë ndaj aktgjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale”, e jo edhe për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, sikurse ka vepruar në rastin konkret i dëmtuari. Andaj, duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura, kjo gjykatë aktgjykimin e ankimuar nuk e vlerësoj sa i përket shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe si të tillë ankesën e të dëmtuarit për këtë bazë ankimore konform nenit 400 të KPPK-së, e hodhi si të palejuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar e vlerësoj vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Sa i përket vendimit për dënim, në ankesën e të dëmtuarit pretendohet se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i butë, dhe se tendenca e të njëjti ka qenë vrasja e të dëmtuarit, dhe se prokurori i shtetit ka vlerësuar vetëm anën subjektive të akuzuarit, ndërsa kërkon nga kjo gjykatë që të merret në mënyrë profesionale me çështjen penale, që dënimi të ketë qëllim pozitiv, ngase në të kundërtën të gjithë do të merreshin me mashtrime dhe do të sulmojnë me thikë, sepse e dinë se do të dënohet me kusht.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e më sipërme ankimore të të dëmtuarit për një dënim më të ashpër, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë konform dispozitave të nenit 73 të KPPK-së, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat

ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit, me ç'rast si rrethana rënduese nuk ka gjetur për të akuzuarin, ndërsa si rrethana lehtësuese për të njëjtin ka marrë parasysh faktin se e ka pranuar fajësinë dhe ka treguar bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjella korrekte e të njëjtit gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, është i gjendjes së varfër ekonomike dhe mbajtës i familjes. Vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të cilat ndikojë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e të dëmtuarit sipas vlerësimit të kësaj gjykate kanë qenë objekt vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë, e meqë në ankesën e të dëmtuarit nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e re rënduese, e që kishte me pas ndikim në shqiptimin e një dënimi më të ashpër, si dhe duke pasur parasysh edhe mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar ndaj të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me dënimin e shqiptuar kryerësi do ta parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e peronave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

PA1.nr.1288/2017, datë 17.01.2018

Bashkëp. profesionale  
Ilmije Zeka

Kryetari i kolegjit  
Hashim Çollaku

### **Anëtarët e kolegjit:**

Ferit Osmani  
Biljana Rexhiq